

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

**AHLAKU I MUHAMMEDIT
S.A.V.S.**

Imam Gazali

Prishtinë 2017

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
Kitâbu âdâbi'l- maishet ve ahlâki'n-nubuvvet
Libri 20

Përktheu
Shenaj Zeneli

Lektor
Artan Sadiku

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut. Ai Allah që krijoi gjithçka, në formën më të bukur dhe e zbukuroi atë që krijoi. Krijoi edhe Muhammed Mustafanë, salat e selam qofshin mbi të, në mënyrën më të bukur, ia zbukuroi edukimin, ia pastroi ahlakun¹ cilësitë, dhe e mori si të zgjedhurin dhe më të dashurin e Tij. Atyre që ju dhuroi hidajet² ju mundësoi ta pasojnë rrugën e tij, e atyre që i dërgoi në humbje, zbukurimin me ahlakun e tij ua bëri haram.

Salat dhe selam zotërisë tonë, Muhammedit s.a.v.s., prijës i pejgamberëve, edhe ehli-bejtit e as'habëve të tij, të ndershëm e të pastër.

¹ *Ahlak* (sh. *Hulk*): moral; shprehje; veçori; natyrë; karakter; sjellja dhe qëndrimi moral i njeriut.

² *Hidajet*: udhëzim; orientim; drejtësi; rrugë e drejtë; rrugë e vërtetë; ta shohësh të vërtetën të vërtetë dhe të kotën të kotë, e të hysh në rrugë të drejtë; Islam.

Pas kësaj dije se:

*edebet*³ e jashtme (*zahir*) janë shenjë e edebeve të brendshme (*batin*), lëvizjet e gjymtyrëve trupore janë fryt i zemrës, ndërsa veprimet janë rezultat i ahlakut. Mirësjellja dhe edukimi lind nga *marifeti*⁴. Zemra, që në vete e fsheh dashurinë, është burim i veprimeve dhe vend i shfaqjes. Shkëlqimi në të jashtmen, është drita (*nuri*) që lind në zemër. Ky nur e zbukuron të jashtmen dhe shndrit. Gjendjet e shëmtuara dhe të këqija ndryshohen në gjendje të mira. Zemra e atij që nuk është penduar, as gjymtyrët tij nuk do të jenë penduar. Zemra e atij që nuk është ngrohur me nurin hyjnor, as në veprime nuk do t'i shfaqen bukuritë e edebeve të Pejgamberit.

Mendova që ta përfundoj çerekun e këtij vëllimi, e që flet për edebin, me një libër që do të përmbledhte të gjithë edebin e jetesës, për atë që e kërkon, që të mos e ketë të vështirë e ta mbledhë nga libra të shumtë. E kam vërejtur se librat që flasin për edebin janë vetëm përmbledhje të disa edebeve. Prandaj më erdhi vështirë përsëritja. Përsëritja është mundim, dhe zemrës i vjen i vështirë.

³ *Adab* (sh. *Edeb*): edukim; ahlak i bukur; urtësi; i ndrojtur/i marrshëm; metodë; rrugë; sellje; mirësjellje; rregullat e sjelljes

⁴ *Marifet*: njohuri; njohja e të vërtetës.

Prandaj vendosa që në këtë libër të ndalemi vetëm në edebin e Resulallahut, s.a.v.s., në ahlakun e tij, e për të cilin flasin shumë transmetime.

Do t'i përmend të gjitha, një nga një, bashkë me edebet tjera, e kështu edhe imani do të freskohet, sepse kjo vjen me njohjen e ahlakut të tij. Përmes dëshmisë së ahlakut të tij fisnik, i jepet fuqi e re imanit dhe forcimit të tij, ku secili transmetim, në vetvete, kategorikisht e dëshmon që ai, s.a.v.s., ishte krijesa më fisnike e Allahut, me gradën më të lartë dhe me vlerën më të madhe, e lëre më të gjitha transmetimet së bashku. Duke folur për ahlakun e tij, do të përmendim edhe pamjen e tij të jashtme, *muxhizet*⁵, që janë vërtetuar me transmetime të drejta, që në saje të kësaj të kuptohet më mirë natyra dhe ahlaku, vlera e lartë e tij dhe për t'ia mbyllur gojën atyre që e mohojnë pejgamberllëkun e tij. Allahu Teala ndihmon në përshtatje të ahlakut dhe gjendjeve tjera Muhammedit s.a.v.s.. Allahu Teala udhëzon të humburit dhe pranon lutjet e nevojtarëve.

⁵ *Muxhize*: mrekulli (më lartë se kerameti), të cilën njerëzit nuk kanë mundësi ta bëjnë përveq pejgamberëve të cilëve Allahu Teala ju ka mundësuar; një vërtetim prej anës së Krijuesit të gjithësisë për Pejgamberët e tij; paraqitje e mrekullisë apo gjendjeve të jashtëzakonshme të Pejgamberëve (alejhimusselam) me lejën e Allahut Teala si dëshmi për pejgamberllëkun e tyre. Për muxhizet është lajmëruar dhe konstatuar në hadithet *sahih*.

Së pari do të tregojmë se si Allahu Teala e edukoi Muhammedin s.a.v.s. me Kur'anin Kerim, më pas do të flasim për vlerën e lartë të ahlakut të tij të pashoq, më pas diçka nga edebi dhe morali i tij, pastaj mënyrën e të folurit dhe buzëqeshjen e tij, virtytet e tij dhe edebet në të ushqyer, virtytet dhe edebet tek veshja, më pas për faljen e tij ani pse kishte fuqi për hakmarrje, për ngurrimin i tij nga ajo që nuk e pëlqente, më pas për xhymertllëkun (bujarinë) dhe mirësinë e tij, trimërinë dhe fuqinë e tij, modestinë e tij, pamjen e tij, pastaj muxhizet dhe shenjat që dëshmojnë vërtetësinë e pejgamberllëkut të tij, salatet dhe selami qofshin mbi të.

EDUKIMI ME KUR'AN NGA ALLAHU I TË ZGJEDHURIT DHE MË TË DASHURIT TË TIJ, MUHAMMEDIT S.A.V.S.

Resulallahu s.a.v.s., gjithmonë kërkon nga Allahu Teala të zbukurohet me ahlak dhe edukim të mirë dhe në duá do të thoshte:

“Allahu im, zbukuroje pamjen time dhe ahlakun tim!”⁶

Gjithashtu thoshte:

“Allahu im, largo nga unë veset e këqija.”⁷

Allahu Teala iu përgjigj duasë së tij, me premtimin hyjnor:

“Lutmuni Mua, e Unë do t’ju përgjigjem!”

40- Gafir: 60,

dhe ia shpalli Kur’anin, e me të e edukoi. Kështu, Kur’ani u bë ahlaku i tij.

Sa’d ibn Hisham tregon:

“Hyra tek Aisha, Allahu qoftë i kënaqur me të dhe babanë e saj, dhe e pyeta për ahlakun e Muhammedit, s.a.v.s., e ajo më tha:

- A lexon Kur’an ti?

⁶ Ibn Mesudi nga Aisha r.a., ekzistojnë edhe rrugë dhe transmetime tjera.

⁷ Tirmidhiu nga Kutbe b. Maliku; Hakim ka thënë se është i besueshëm, sahih.

- *Natyrisht; i thashë, e atëherë, ajo më tha:*

- *Ahlaku i Resulallahut s.a.v.s., ishte Kur'ani.*

Kur'ani Kerim e edukoi Muhammedin s.a.v.s., me fjalët e Allahu Teala:

“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit.” 7-A'raf: 199,

“Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën.”16- Nahl: 90,

“...bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” 31-Lukman: 17,

“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”

42-Shura: 43,

“Pra falju dhe hiq tyre. Allahu i do ata që bëjnë mirë.” 5-Maide: 13,

“...le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t'u falë ju?”

24-Nur: 22,

“Të keqen ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.”41-Fusilet: 34,

“...e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”3-Al-Imran: 134,

“...largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin!” 49- Huxhurat: 12.

Kur në betejën e Uhud-it Resulallahut s.a.v.s., iu çua faqja dhe iu thye dhëmbi, gjaku rridhte nëpër fytyrë, e ai, s.a.v.s., e fshinte gjakun me dorë, dhe thoshte:

“Si do të arrijë shpëtimin populli që fytyrën e të Dërguarit të Allahut e mbushi me gjak, e ai i thërret në shpëtim?”⁸

Atëherë Allahu Teala e shpalli ajetin:

“Ti nuk ke asgjë në dorë.” 3-Al’Imran: 128,

si mënyrë edukimi. Shembuj të këso mënyrave të edukimit në Kur’an ka plot.

⁸ Muslimi nga Enesi, ndërsa si pezull (*muallak*) e transmeton edhe Buhariu.

Pikërisht Resulallahu s.a.v.s., është i pari përmes të cilit bëhet edukimi dhe zbatimi i ahlakut. E më pas, ky nur prej tij përhapet tek njerëzit e tjerë. Ai ishte edukuar me Kur'an dhe të tjerët i edukoi më atë. Prandaj, Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Jam dërguar të plotësoj bukuritë e ahlakut.”⁹

Për këtë kemi folur në librin **‘Shërimi i zemrës, zbukurimi i ahlakut dhe edukimi i nefsit’**, prandaj të mos përsëritemi.

Pasi Allahu Teala e ngriti në shkallën e përsosur ahlakun e Resulallahut s.a.v.s., duke e lavdëruar Resulallahun, s.a.v.s., tha:

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të ahlakut.”

68-Kalem: 4

I lavdëruar qoftë Allahu Teala! Shih mirësinë e Tij të pafund dhe dashamirësinë e madhe; fillimisht dhuron, e pastaj lavdëron! Vet e zbukuroi Resulallahun s.a.v.s., me ahlak të bukur, e më pas këtë virtyt ia përvetësoi atij, duke i thënë:

“Ti je në një shkallë të lartë të ahlakut.”

⁹ Ahmedi, Bejhakiu dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a.

E më pas Resulallahu, s.a.v.s., ju sqaroi njerëzve se
***“Allahu Teala e do ahlakun e bukur, e i urren
sjelljet e shëmtuara.”***¹⁰

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

*“Sa e çuditshme është me muslimanin që i vjen
vëllau me një kërkesë, e ky nuk i ndihmon, ani pse ka
mundësi. Edhe nëse nuk shqetësohet për sevap e
gjynah, në emër të njerëzimit dhe ahlakut të bukur
duhet ta ndihmojë, sepse kjo është rruga e shpëtimit.”*

Dikush e pyeti:

- A e ke dëgjuar këtë nga Resulallahu s.a.v.s.?; në
çka Alia r.a., tha:

- Nga ai kam dëgjuar diçka edhe më të bukur; kur ia
sollën robët e luftës nga fisi Taxhxh, mes tyre ishte një
vajzë rob lufte, që tha:

- O Muhammed, a është e mundur të më lirosh, e të
mos poshtërohem te fiset arabe? Jam vajza e kryetarit
të fisit; babai im e do drejtësinë, tregohet i sjellshëm me
ata që udhëheq, liron robët e luftës, ushqen të uriturit,
përsëndetë, ai që vjen me një nevojë nuk e kthen duar
thatë, është i xhymentë dhe bujar. Unë jam Suffjan, e bija
e Hatim Tai; e Resulallahu s.a.v.s., tha:

¹⁰ Bejhaki nga Sehl ibn Sa'da.

- O skllave, këto që i përmende janë cilësi të besimtarit. Po të ishte babai yt musliman, do të luteshim për mëshirë (rahmet) ndaj tij. Lirojeni këtë vajzë, , sepse babai i saj e do ahlakun e bukur, e edhe Allahu Teala e do ahlakun e bukur.

Ebu Burde Ibn Nijar u ngrit, e tha:

- O i Dërguari i Allahut, a e do Allahu ahlakun e bukur? Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, në Xhennet hyn vetëm ai me ahlak të bukur.¹¹

Muadh b. Xhebel r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu Teala Islamit e pajisi me ahlak dhe vepra të bukura.”

Prandaj njeriu me ahlak të bukur shoqërohet me të tjerët, bën vepra të dobishme, flet këndshëm, është bamirës, ushqyen të tjerët, i jep selam secilit, viziton vëllaun e sëmurë, shkon në xhenaze të vëllaut musliman, është komshi i mirë - qoftë me musliman apo pabesimtarë, respekton muslimanët e moshuar, i përgjigjet ftesës për gosti, falë, pajton njerëzit, është bujar dhe fisnik, toleron, i pari jep selam, e mposhtë zemërimin, i falë gabimet, largohet nga ajo që islami e ka ndaluar siç është kotësia, përtacia, lojërat, bixhozi,

¹¹Tirmidhiu dhe Hakimi transmetojnë në **'Nevadiru'l-Usul'**.

thashethemet, gënjeshtria, koprracia e lakmia, mizoria, dinakëria, mashtrimi, shpifjet, marëdhëniet e këqija me njerëz, ndërprerja e lidhjeve farefisnore, ahlaku i keq, vetë-lavdërimi e vetë-pëlqimi, poshtërimi i tjetrit, fy rjet, fjalët e pamoralshme, kërkimi i mangësive të tjetrit, urrejtja, xhelozia, keq-interpretimi, egërsia, paragjykimi, mendjemadhësia, luksi e teprimi, shfrenimi e ndyrësitë, keqdashja e zilia, besimi i kotë, dhuna, armiqësia e padrejtësia. Largimi prej këtyre është nga ahlaku i bukur.

Enesi, r.a., tregon:

“Nuk ka ndodhur që Resulallahu, s.a.v.s., të përmend ndonjë mirësi, e të mos na ftojë në të, dhe nuk ka ndodhur që të përmend ndonjë ligësi, e të mos na këshillojë t’i largohemi.”

E të gjitha këto që u përmendën, i përfshinë ajeti:

“Allahu urdhëron drejtësinë dhe mirësinë.”

(16- Nahl: 90).

Muadhi tregon se Resulallahu, s.a.v.s., e këshilloi:

- O Muadh! Ta këshilloj frikën prej Allahut, sinqeritet në fjalë, mbajtje të premtimit e kryerje të obligimit, braktisjen e tradhëtisë, mbrojtjen e komshisë, mëshirë ndaj jetimit, të folur butë, t’i japësh salam çdokujt dhe të jesh modest, të jesh në punë të

mira, të mos jesh pesimist, t'a ruash besimin (iman), ta kuptosh Kur'anin, dashurinë ndaj Xhennetit, frikë nga dhënia e llogarisë dhe shtrirje e dorës ndaj çdokujt me dashamirësi. T'i ndaloj fjalët e këqija për dijetarët, të vërtetës t'i thuash gënjeshtër, t'i përshtatesh gjynahqarit, kryengritjen ndaj udhëheqësit të drejtë. Ta këshilloj devotshmërinë kudo që të jesh, dhe që për secilin gjynah tëndin menjëherë ta pasojë teubeja (pendimi) – për gjynah të bërë fshehtaz, edhe teube bëje fshehtas, e për gjynah të bërë haptazi, edhe teuben bëje haptazi.”¹²

Pra, kështu Resulallahu a.s., fton në edukatë dhe ahlak të bukur, kështu i ka lartësuar robët e Allahut, me fisnikëri dhe me fjalë të mira.

¹² Ebu Naim në *'Hilje'* dhe Bejhakui në *'Shuabu'l-Iman'*.

PJESË NGA AHLAKU I RESULALLAHUT, S.A.V.S.,
PËRMBLEDHUR NGA TREGIMET E DISA DIJETARËVE

Resulallahu s.a.v.s., ka qenë njeriu më i butë, më trimi, më i drejti, më i ndershmi dhe më i virttyshmi. Dora e tij kurrë nuk ka prekur dorën e ndonjë femre që nuk ka qenë nën kurorën tij. Ishte njeriu më bujar, sa që asnjë dinar apo dërhëm nuk e ka kaluar natën te ai. Kur i mbetej diçka që nuk kishte me kë t'a ndante, e nata të vijë, nuk kthehej në shtëpi deri sa t'a ndante me ndonjë nevojtar.

Nga furnizimi i Allahu nuk merrte më shumë se që i nevojitet për një vit, dhe atë nga elbi dhe hurma më e thjeshtë, e të tjerat i dhuronte për rizanë e Allahut. Nuk ka ndodhur që dikush t'i kërkojë, e ai të mos e japë atë që kishte, aq sa shpesh edhe vet ishte nevojtar ende pa përfunduar viti, e të mos kishte të ardhura tjera.

Vet i riparonte sandalet e veta, i qepte rrobat e veta, ndihmonte familjarët në punët e tyre, bashkë me ta e copëtonte mishin. Ishte njeriu më i turpshëm nga të gjithë. Nuk do t'i ndalte sytë në fytyrën e askujt.

Merrte pjesë në ftesën e skllavit, zotërisë, të voglit, të madhit, secilit. I pranonte dhuratat, qoftë edhe vetëm një gllënjë qumështi, apo *paçe*¹³. Ai shpërblente

¹³ Gjellë me mish edhi.

për dhuratën, dhe e hante gjellën që e mernte si dhuratë. Por, sadakanë nuk e hante. Nuk hezitonte t'i përgjigjej ftesës së skllavit dhe të varfrit. Zemërohej për Allahun e kurrë për veten. I qëndronte besnik të vërtetës, edhe po të ishte në dëmin e tij, apo të as'habëve të tij. Njëherë iu ofrua ndihmë nga disa myshrikë (politesitë) kundër myshrikëve tjerë, e ishin pak në numër dhe kishin nevojë për ndihmë, por ai nuk pranoi dhe tha:

“Nuk ndihmohem nga myshrikët.”

Një hebre u gjet i mbytur në mesin e as'habëve. Kundër tyre gjykoi dhe nuk u nda nga drejtësia. Edhe pse as'habët kishin nevojë edhe për një deve, ai gjykoi me njëqind deve pagesë për gjak. Ka ndodhur që ka lidhur gur mbi bark për shkak të urisë. Nuk refuzonte atë çfarë kishte për të ngrënë, dhe asnjëherë nuk largohej nga ushqimi që ishte hallall. Nëse në vend të bukës kishte hurma, i hante hurmat. Nëse kishte mish të pjekur, e hante. Edhe nëse kishte bukë elbi, e hante. Nëse kishte ndonjë ëmbëlsirë apo mjaltë, poashtu e hante. Nëse kishte qumësht, mjaftohej me të. Po të kishte shalqi, pjepër, perime apo pemë të freskëta edhe ato i hante.

Nuk hante mbështetur, as në tavolinë. Tri ditë nuk u ngop me bukë gruri, nga bujaria për të tjerët, jo nga varfëria ose koprracia dhe kjo vazhdoi deri në vdekje. I

përgjigjej ftesave për dasëm, vizitonte të sëmurët dhe merrte pjesë në varrime. Në mesin e armiqëve shkonte vetëm e pa roje. Ishte më modesti prej njerëzve dhe më i qeti, nuk mburrej, dhe fliste me kuptime të gjera e të thella, pa e zgjatur, e me fytyrën më të buzëqeshur. Asgjë nga kjo botë nuk e tërhiqte. Veshte çfarë kishte, herë roba të vjetra, herë xhybe të Jemenit dhe herë xhybe të leshtë. Çka lejohej, atë e veshte. Unazën e kishte nga argjendi dhe e mbante në gishtin e vogël të dorës së djathtë, por edhe në të majtën. Kur kalëronte, mbrapa në shalë merrte edhe shërbëtorin apo dikë tjetër. Kalëronte atë kafshë që e kishte afër, herë kalin, herë devenë, mushkën apo gomarin, e nganjëherë shkonte edhe në këmbë, i zbathur, pa xhybe, pa çallmë e pa kapelë. I vizitonte të sëmurët në pjesët më të largëta të Medines. Pëlqente aromat e këndshme, e neveritej nga erërat e këqija. Shoqërohej me fukara dhe hante me ta. I nderonte ata që bënin mirë në vendin e tyre, derisa me dashamirësi i mbante lidhjet me ata që kishin ndikim. I ruante lidhjet farefisnore, e nuk bënte dallim mes tyre. Nuk bënte padrejtësi. E pranonte kërkimfaljen. Bënte shaka, por e fliste vetëm të vërtetën. Qeshte, por jo zëshëm. I shikonte lojërat e lejuara (mubah) dhe nuk i ndaloi. Garonte me bashkëshorten. Nganjëherë e ngrisinin zërin kundër tij, por ai duronte.

I kishte disa deve dhe dele që mjeleshin, e me qumështin e tyre e ushqente familjen dhe veten. I kishte disa skllave dhe skllavë, por ai nuk do t'i largonte prej tij në ushqim dhe veshje. Nuk e kalonte asnjë moment ndryshe pos në ibadet për rizanë e Allahut Teala, ose për gjëra të domosdoshme. Dilte në vreshtat dhe kopshtet e as'habëve. Nuk e nënvlerësonte fukaranë për shkak të varfërisë, as nuk e mbivlerësonte të pasurin për shkak të pasurisë. Secilin e ftonte tek Allahu në mënyrë të njëjtë. Allahu Teala mblodhi te ai gjithë ahlakun dhe cilësitë e bukura në mënyrë të përsosur për udhëzimin në rrugë të drejtë. Ai nuk ishte shkolluar (ishte *ummi*); as nuk lexonte as nuk shkruante. U rrit në vende të padituriisë dhe shkretëtirë, në varfëri, duke ruajtur delet, jetim - pa baba e pa nënë, e Allahu ia mësoi të gjitha vlerat e larta të ahlakut dhe e bëri posedues të cilësive më të mira, ia shpalosi njohuritë nga e kaluara dhe e ardhmja, ia tregoi rrugët e lumturiisë dhe shpëtimit, ia tregoi rrugën e dashuriisë së ahiretit, ia mësoi zbatimin e detyrimeve (*vaxhib*) dhe braktisjen e të kotës.

Allahu Teala na ndihmoftë t'i përshtatemi në çdo punë Resulallahut s.a.v.s., amin ja Rabbel-alemin.

Sipas transmetimit të Ebu’l-Buhturit, Resulallahu s.a.v.s., nuk ka qortuar askënd nga muslimanët. Nëse do të ndodhte që me fjalë të lëndojë ndonjë person, menjëherë ia heqte mërzinë. Poashtu kurrë nuk mallkoi; as ndonjë grua apo shërbëtor. Në një luftë kërkonin nga ai që të mallkojë armiqtë, e ai (në këtë) tha:

“Unë jam dërguar si mëshirues. Nuk jam dërguar si mallkues!”¹⁴

Kur kërkonin nga ai që të mallkojë muslimanin apo pabesimtarin, qoftë bashkë apo ndaras, ai bënte dua. Asnjëherë me dorën e tij nuk ka goditur askënd, përveç për rizanë e Allahut. Kurrë nuk është hakmarrë në emër të vet, përveç për drejtësinë e Allahut. Kur i ofrohej të zgjedhë mes dy gjërave, e zgjedhte më të padëmshmen, pos kur aty kishte haram ose shkëputje të lidhjeve familjare; atëherë as nuk afrohej andej. Kur kërkonin nga ai, qoftë skllavja apo skllavi, qoftë i pasuri apo fukaraja, çdokujt ia plotësonte nevojat. Enesi r.a., ish-skllav i Resulallahut s.a.v.s., nën betim tregon:

- *Kur bëja një punë që nuk i pëlqente, kurrë nuk më ka thënë:*

- ***Pse e bëre këtë kështu?***

¹⁴ Muslimi nga Ebu-Hurejre r.a.

E kur gratë e tij tentonin të më qortojnë, i parandalonte dhe thoshte:

- Lëreni! Puna e tij është në pajtim me libër dhe kader.

Nuk ka kritikuar asnjë lloj shtrati në të cilin shtrihej. Nëse do t'ia shtronin, ai do të shtrihej, e nëse nuk shtronin gjë, ai do të shtrihej në tokë.

Allahu Teala, ende pa e dërguar Muhammedin a.s., si peygamber, në rreshtin e parë të Tevrat-it thotë:

“Muhammedi është i dërguari (resuli) Im dhe robi Im i përzgjedhur, as i vrazhdë as i sertë. Nuk endet rrugëve, të keqes nuk i përgjigjet me të keqe, por falë dhe është i mëshirshëm. Vendlindje e ka Mekën, jetë ndërron në Taba (emërtim tjetër për Medinen), e pushtetin e ka në Sham. Ai dhe njerëzit e tij do të vishen me *izar* (shami-mbulesë). Do të thërrasin në Kur'an dhe dituri, e do të marrin abdes.”

Kështu përshkruhet edhe në Ungjill.

Nga ahlaku i bukur të tij ishte që gjithmonë i pari i jepte selam atij që e takonte. Nëse kishte ndonjë nevojë, i'a plotësonte. Nëse dikush ia shtrëngonte dorën, nuk do ta tërhiqte deri sa personi tjetër i pari të largojë dorën. Kur takonte ndonjërin nga as'habët, i pari e shtrinte dorën për përshëndetje. E merrte për dore dhe e shtrëngonte.

Me bismilah ulej e me bismilah ngrihej. Nëse dikush hynte brenda sa ishte me namaz, e shkurtonte namazin, kthehej nga ai dhe e pyeste a ka ndonjë nevojë. Pasi i dilte në ndihmë, i kthehej namazit. Zakonisht ulej me këmbët mbledhur dhe me duart e shtrira mbi to. Vendi ku ulej nuk dallonte nga vendet e as'habëve, sepse ulej aty ku kishte vend të lirë.

Asnjëherë nuk është parë që në mesin e as'habëve t'i shtrijë këmbët, pos kur ishin pak, e kishte vend të mjaftueshëm. Ulej kryesisht i kthyer kah kibla.

I shprehte nder (*ikram*) secilit që e vizitonte, aq sa edhe xhuben e trupit ua bënte shtrojë. Mysafirit ia ofronte jastëkun e vet që të ulej në të, dhe insistonte deri sa mysafiri të pranonte. Kujtdo që i drejtohej, ai mendonte se ishte më i dashuri tek Resulallahu s.a.v.s.. I drejtohej secilit në mexhlis, veç-e-veç, dhe drejtonte fytyrën kah ai. Mënyra se si ulej, si dëgjonte, si fliste, mënyra si ju drejtohej të tjerëve dhe mirësjellja e tij ishte shumë e singertë. Mexhlisi i tij ishte mexhlis i edukimit, urtësisë, modestisë e kënaqësisë shpirtërore. E Allahu Teala thotë:

“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.”

3-Ali Imran: 159

As'habët e tij i thërriste me llagap, u jepte edhe atyre që nuk kishin llagap, e pastaj ashtu i thërrisnin edhe të tjerët. Llagap u jepte edhe grave që kishin fëmijë, por edhe atyre që nuk kishin fëmijë. Kështu bënte edhe me fëmijët, që t'ju gëzonte zemrat.

Nga të gjithë njerëzit, më së vështiri zemërohej, e më së shpejti mjaftohej e kënaqej. Në mesin e tyre ishte më bujari, më i miri me të gjithë dhe më i hairit. Në shoqërinë e tij nuk ngriteshin zërat. Kur ngritej prej mexhllisit thoshte:

“Subhanekelahumme ve bi-hamdike, eshhedu en la ilahe ila ente, estagfiruke ve etubu ilejke

(Lavdërimi Ty o Rabbi im, me hamd (falënderim) ndaj Teje, dëshmoj se nuk ka ilah tjetër pos Teje, nga Ti falje kërkoj dhe Ty të bëj teube)”;

Më pas thoshte se këto fjalë ia kishte mësuar Xhebraili, a.s..

FJALIMI I TIJ DHE BUZËQESHJA E TIJ

Resulallahu, s.a.v.s., kishte të folme të kuptueshme dhe tejet të ëmbël. Vet ka thënë:

“Unë jam më të folmen më të kuptueshme mes Arabëve.”

Edhe banorët e Xhennetit do të flasin me të folmen e Muhammedit, s.a.v.s.. Kur fliste, nuk e zgjaste, të folmen e kishte të qetë e fjalët si perla të radhitura një pas një.

Ajsha r.anha., ka thënë:

“Ai nuk i zgjaste fjalët. E folmja e tij ishte e shkurtër, e ju tash, kur folni, po e teproni.”

Edhe kanë thënë - ai ishte njeriu që fliste në thelb, në fjali të shkurtër përmbledhte gjithë atë që kishte për qëllim të thoshte. Fliste me përmbajtje dhe ishte i qartë. As nuk e tepronte as nuk fliste pak. Fjalët e përcjellnin njëra-tjetrën, por bënte pushime të shkurta, në mënyrë që të mbanin në mend ata që e dëgjonin.

Zërin e kishte më të ngrohtin, dhe më të këndshmin. Nuk thoshte fjalë të panevojshme. Fliste të vërtetën, edhe kur ishte me disponim të mirë, edhe kur ishte i zemëruar. Largohej nga ai që nuk fliste bukur.

Kur detyrohej të fliste për diçka që nuk i pëlqente, fliste me simbolikë. Kur nuk fliste, flisnin as'habët. Në bisedë me të nuk kishte grindje. Ishte serioz edhe kur jepte këshilla dhe thoshte:

“Mos e mohoni Kur'anin me Kur'an. Ai është shpallur në shumë kuptime.”¹⁵

Ishte personi që më shumti buzëqeshte kur flisnin as'habët e tij. I dëgjonte me admirim fjalët e tyre, për të qenë ata të kënaqur. Nganjëherë buzëqeshte aq sa i shiheshin dhëmbët. Duke iu përshtatur atij, edhe as'habët, në biseda me të ishin të buzëqeshur.

Tregohet se si një ditë i erdhi një beduin, për ta pyetur rreth një çështje, derisa Resulallahu s.a.v.s., ishte i mërzitur. As'habët i thanë:

“Lëre, sot mos pyet, Resulallahu s.a.v.s., është i mërzitur.” Beduini tha:

“Më lejoni! Unë nuk do ta lë atë, derisa të buzëqeshë.” Më pastaj i tha:

- O i Dërguari i Allahut! Kemi dëgjuar se kur të vijë Dexhalli, me vete do të ketë tirid¹⁶, e do t'i ushqejë njerëzit me të, e ata që nuk do të hanë, do të vdesin nga uria!

¹⁵ Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Hattabai se Kur'ani është shpallur në shtatë mënyra.

¹⁶ Përshesh buke me lëng mishi.

O ti që më je më i dashur se nëna e babai, më trego, çfarë të bëj? A të vdes nga uria duke mos ngrënë, apo të ha deri sa të ngopem e të trashem, e pastaj të besoj në Allah, e ta mohoj Dexhallin?

Resulallahu, s.a.v.s., aq shumë buzëqeshi sa iu panë edhe dhëmbët, e i tha këtij beduinit:

- Jo, mos ha nga ai, Allahu Teala nuk do të mbytë nga uria.¹⁷

Thuhet se Resulallahu s.a.v.s., ishte më i buzëqeshuri nga të gjithë. Ishte zemërbardhë. Vetëm kur i vinte Shpallja, kur fliste për ditën e Gjykimit apo ju tërheqte vërejtjen njerëzve në hutbe, i ndërrohej fytyra. Kur ishte i lumtur dhe gëzohej, asnjëri nuk e kishte kënaqësinë si të tij. Ndërsa *va'zi* (këshilla) i tij ishte shumë serioz. Kur hidhërohej, e hidhërohej vetëm për Allahun, dhe në gjendje të hidhërimit nuk bënte asgjë. Ashtu ishte edhe në të gjitha çështjet tjera. Kur përballej me vështirësi thoshte: **“Lahavle vela kuvvete illa billah”**, dhe i'a linte Allahut, e pastaj kërkonte udhëzim nga Allahu, duke bërë dua:

¹⁷ Në hadithet e dëshmuara theksohet vetëm se si Dexhalli do të ketë një mal me bukë dhe një lum më ujë (dmth. shumë ushqim), e në hadith që shënohet nga Muslimi, pranë bukës përmendet edhe mishi. Poashtu, që të dy, edhe Buhariu dhe Muslimi, shënojnë nga Huzejfe dhe Ebu Mesud se pos ujit do të kenë edhe zjarrin.

“Allahu im, ma trego të vërtetën si të vërtetë që unë t’i përshtatem asaj. Ma trego të keqen si të keqe që të jem larg nga ajo. Mos lejo që ajo të më mashtrjë, e unë të filloj ta pasoj epshin tim, pa udhëzimin Tënd. Epshin tim bëje që të nënshtrohet Ty. Më udhëzo kur kam dyshime, dhe më drejto në zbatimin e urdhreve Tua. Ti je Ai që e udhëzon në rrugë të drejtë kë të duash Ti.”

EDEBI DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S., NË
USHQIM

Resulallahu s.a.v.s., ushqejej me atë që kishte. Më së shumti i pëlqente të hante me kallaballëk.

Kur shtrohej sofrë, lutej:

“Bismil’lah (Me emrin e Allahut), Allahu im, bëje këtë ushqim të dobishëm dhe të jemi falënderues, bëje që me të të arrijmë edhe nimetet e Xhennetit.”

Kur ulej të hante, ulej sikur në namaz, dhe thoshte:

“Unë jam rob. Ha si rob dhe ulem si rob.”¹⁸

Nuk e hante ushqimin e nxehtë. Thoshte:

“Ushqimi i nxehtë është pa bereqet. Allahu nuk na ushqen me zjarr, prandaj lejeni ushqimin të ftohet!”¹⁹

Hante para vetes. Hante me tre gishta. Nganjëherë i përdorte edhe katër gishta, por me dy gishta nuk ka ngrënë, dhe për ngrënien me dy gishta ka thënë:

“Ashtu ha shejtani.”²⁰

¹⁸ Hadithin e transmeton Bezzariu.

¹⁹ Bejhaki nga Ebu Hurejre r.a.

²⁰ Darekutni në *‘El-Ifrad’* nga Ibn Abasi.

Një herë i erdhi Osmani r.a., e i solli gjellë paluze. Resulallahu s.a.v.s., nisi të hajë, dhe pyeti:

- ***O Ebu Abdullah, çfarë është kjo? Si e bëni?***

Osmani r.a., tha:

- *O Resulallah, ti që më je më i dashur se nëna e babai! Yndyrën dhe mjaltin e vendosim në tenxhere, e tenxheren në zjarr, deri sa shkrihet. Më pas shtojmë grurë të bluar dhe e përziejmë deri sa të jetë gati, kështu, si hallvë.*

Në këtë, Resulallahu a.s. i tha:

- ***Vërtetë është gjellë e mirë.***²¹

Resulallahu, a.s., hante bukë elbi. Hante edhe tranguj të kripur, me hurme të freskëta.

Nga pemët më së shumti pëlqente hurme të freskëta, pjepër, shalqi dhe rrush. E kishte zakon që shalqinin ta hante me bukë dhe me sheqer, dhe nganjëherë edhe me hurme të freskëta. Pjepërin dhe shalqirin e hante me të dy duart. Hante hurme me dorën e djathtë, e në të majtën i mbante farat.

Kështu, një herë, afër i kaloi një dele, e Resulallahu s.a.v.s., ia drejtoi farat e hurmeve. Delja filloi të hajë nga dora e tij e majtë, e Resulallahu s.a.v.s., hante me dorën e djathtë, derisa nuk përfundoi dhe delja u largua.

²¹ Ibn Maxhe nga Ibn Abbasi.

Rrushin nganjëherë e hante duke e kafshuar kokrrën, e prej mjekrës i pikonte lëng rrushi, sikur perla.

Ushqimi i tij zakonisht përbëhej nga uji dhe hurmet. I bënte bashkë qumështin dhe hurmet, dhe këtë e quante ushqim të shijshëm.

Ushqimin më të dashur e kishte mishin. Thoshte:

“Mishi shton dëgjimin e veshit. Është ushqim i mirë, edhe në dynja edhe në ahiret. Sikur të kërkoja nga Rabbi im që të më ushqejë me mish për çdo ditë, Ai do t’a bënte këtë.”²²

Gjellën tirid e hante me kungull. E donte kungullin, dhe thoshte:

“Kungulli është perime e vëllait tim Junusit, Alejhisselam.”²³

Aisha r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., i thoshte:

“Oj Aishe, kur e vendos tenxheren që të zihet, shto më shumë kungull. Kungulli përforcon zemrën.”²⁴

Hante edhe mishin e zogut që kapej në gjah; vet nuk dilte në gjueti, por e pëlqente që t’i sjellej ndonjë pjesë nga ajo e ta hante. Kur hante mish, nuk e ulte kokën drejt mishit, por mishin e afronte te goja, e pastaj e hante.

²² Ebu’sh-Shejh nga Ibn Sema.

²³ Ibn Maxhe nga Enesi, r.a.

²⁴ Hadithi është cekur në *‘Fevaid’* të Ebu Bekir esh-Shafisë.

Bukën e hante me gjalpë. Nga delja i pëlqente kërci nën gju dhe supi, nga ushqimi i zier kungulli, nga mëlmesat uthulla.

E pëlqente hurmen *Axhva* dhe bënte dua për bereqet e saj, duke thënë:

“Kjo hurma është nga frytet e Xhennetit. Karshi helmit dhe sihirit (magjisë) është ilaç.”

Nga barishtet e pëlqente *lulen qumështore (astragalus)* dhe *lakrën e egër (portulacca)*. Nuk hante hudhër, qepë të kuqe a purri.

Kurrë nuk ankohej në ushqim; nëse i pëlqente, e hante, e nëse jo nuk hante. Nuk i pëlqente shpretka, edhe pse nuk e ndaloi.

E fshinte enën me gishta, duke thënë:

“Pjesët e fundit të ushqimit sjellin më së shumti bereqet.”²⁵

e në fund lëpinte edhe gishtat. Nuk i fshinte me leckë pa i lëpirë të gjithë gishtat, dhe thoshte:

“Nuk dihet në cilën pjesë të ushqimit është bereqeti.”²⁶

²⁵ Bejheki transmeton hadithin në *‘Shuabu-iman’* nga Xhabiri, r.a.

²⁶ Muslimi nga Ka’ba ibn Malika dhe Xhabiri, r.a. Hadithin me këtë kuptim e transmeton Bejheki.

E kur përfundonte me ushqim, thoshte:

“Allahu im, gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë vetëm për Ty, na ushqeve dhe na ngope, na shuajte etjen dhe na kënaqe, Ty të falënderojmë, nuk jam mos-mirënjohës, nuk e braktisi falënderimin, dhe gjithmonë të falënderoj Ty.”²⁷

Sidomos kur hante bukë me mish, i lante duart mirë, dhe me pjesën e mbetur të ujit e pastronte fytyrën.

Kur pinte, pinte me tri gëllnjëka, dhe çdoherë fillonte me *bismil’lah* e përfundonte me *elhamdylilah* (falënderim) tri herë.

Ujin e pinte ngadalë, jo përnjëherë. Çka mbetej nga pija, i’a jepte personit në të djathtë.

Nëse dikush ulej nga e majta e tij, e ishte në pozitë më të lartë se personi në të djathtën e tij, i thoshte personit në të djathtë:

“Është synet që të jepet ty, por nëse ti do, mund t’i japësh përparësi këtij.”

Me siguri se ndonjëherë ka pirë edhe me një gllënjë të vetme, të gjithën, deri në fund. Nuk fryente në enën nga e cila pinte, dhe merrte frymë vetëm pasi e lagonte gotën nga goja.

²⁷ Taberani nga Haris b. Haris., Buhariu transmeton nga Ebu Umame.

Njëherë ia sollën një gotë plot me qumësht e mjaltë, e Resulallahu, s.a.v.s., refuzoi ta pijë, duke thënë:

- *Dy ëmbëlsira në një ëmbëlsirë, e dy sherbetë në një enë, nuk bën*, e më pas shtoi:

“Nuk po u’a ndaloj, por unë nuk dua të kënaqem në gjëra kalimtare të dynjallëkut e nesër të jap llogari për to. Më shumë e dua thjeshtësinë, modestinë. Allahu Teala i lartëson ata që i përuhlen Atij.”²⁸

Në shtëpinë e vet ishte më i turpshëm se një skllave. Nuk i lodhte familjarët me kërkesa për ushqim. Nëse i jepnin diçka të hante, do të hante. Çfarë i ofronin të hajë - atë e hante dhe çfarë i ofronin të pijë, e pinte. Nganjëherë edhe vet ngritej t’i përgatisë vetes ushqim e pije.

²⁸ Bezzar nga Talha.

EDEBI DHE AHLAKU I RESULTALLAHUT, S.A.V.S., NË
VESHJE

Resulallahu s.a.v.s., veshte atë që kishte: *izar*²⁹, këmishë, xhybe a tjetër. I pëlqente rrobat e gjelbra ani pse më së shumti vishte ngjyrë të bardhë. Për rrobat e bardha thoshte:

“Me to i veshni të gjallët, dhe me to i mbështjellni të vdekurit!”³⁰

Vishte edhe rroba të qëndisura, si në beteja ashtu edhe në raste tjera. I kishte nga pëlhura e hollë dhe e pambuktë, që i përshtatej tepër mirë me bardhësinë e fytyrës. Rrobat nuk ia kalonin thembrën e këmbës, ndërsa *izarin* e kishte edhe më sipër. Këmishën e kishte me pulla, e shpesh i shpërthekonte kur ishte në namaz, apo në raste të tjera.

E kishte edhe një mbulesë të ngjyrosur me safran. Shpesh me njerëzit falej vetëm në të, por shpesh ishte edhe vetëm në mbulesë. Kishte edhe rroba shajaku të cilën e vishte, dhe thoshte:

- *Unë jam rob, edhe vishem si rob.*³¹

²⁹ Veshja me të cilën mbulohet trupi, prej gjoksit deri poshtë.

³⁰ Ibn Maxhe dhe Hakim nga Ibn Abbasi me një varg transmetuesish të besueshëm.

³¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Burde.

I kishte edhe dy palë rroba, vetëm për xhuma. Nganjëherë e vishte vetëm *izarin*, e ia lidhte skajet nën supe, dhe në atë ju falte njerëzve xhenazen. Në shtëpinë e vet falej vetëm nën një izar dhe ky izar ishte në trupin e tij edhe gjatë marrëdhënies në atë natë. Zakonisht natën falte vetëm nën një izar. Izari është një lloj çarçafi. Me një pjesë mbështjellte veten, e pjesën tjetër e hidhte përreth gruas, dhe ashtu falej. Resulallahu, a.s., kishte një palë rroba të zeza, por ia dhuroi dikujt. Kur Ummu Selema e pyeti:

- *Ti që më je më i dashur se nëna e babai, çfarë u bë me ato rrobat e zeza? Kurrë nuk kam parë diçka më të bukur se bardhësia jote në atë të zezë!*; e ai a.s., i tregoi:

- ***I'a fala njërit.***

Enesi r.a., ka thënë:

- *Ka ndodhur që na ka falur namazin e drekës me një shall në shpinë të lidhur në të dy anët.*

Resulallahu s.a.v.s., mbante edhe unazë. Nganjëherë e lidhte një fije në të, që ta përkujtonte në diçka. Në unazë e kishte të shkruar '**Muhammedu'r-Resulullah**', dhe me të i vuloste letrat, dhe thoshte:

- ***Vula në letër është me e mirë se dyshimet.***³²

³² Buhariu dhe Muslimi nga Enesi, r.a.

Çallmën e lidhte rreth kësulës, e atë e mbante edhe kur e heqte çallmën. Shpesh e hiqte kësulën nga koka dhe e linte pranë vetes, si perde kur falte namazin. Shpesh ishte edhe pa çallmë e rreth kokës e mbi ballë mbështjellte ndonjë shami. E kishte edhe një çallmë që e quante *Sehab* (re), të cilën ia fali hazreti Alisë r.a.; e sa herë që Alia r.a. shkonte me atë çallmë të Resulallahu s.a.v.s., i Dërguari a.s., thoshte:

- ***Na erdhi Alia me sehab*** (me retë).³³

Kur vishej, vishej nga e djathta, dhe thoshte:

“E falënderoj Allahun që më veshi me këtë; t’i mbuloj pjesët e turpshme e të dukem mirë mes njerëzve”³⁴; e kur zhvishej, zhvishej nga e majta.

Kur vishte rroba të reja, të vjetrën ia dhuronte fukarasë. Thoshte:

“Kur një mysliman, për rizanë e Allahut e *mbulon* myslimanin e varfër me rrobë të vjetër, Allahu Teala e ‘*mbulon*’ atë me mbrojtjen e Tij, me sigurinë dhe mirësinë e Tij, deri sa i varfri t’i përdorë ato, i gjallë apo i vdekur (për qefin).”³⁵

³³ Ibn Adijj dhe Ebu’sh-Shejh transmeton nga Xhaferi ibn Muhamed, ai nga babi i tij, dhe ky nga gjyshi i tij. Nga ana tjetër, Ebu Nuajm shënon në *‘Delailu’n-Nubuvve’* hadithin ku përmendet çallma e të Dërguarit, a.s., me emrin Sehāb.

³⁴ Shënon Tirmidhiu. Hadithin e transmeton edhe Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Omer b. Hattabi r.a., derisa Hakimi thotë se hadithi është i besueshëm

³⁵ Hakimi në *‘Mustedrek’* dhe Bejhekiu në *‘Shuab’* nga Omeri r.a.

Resulallahu, s.a.v.s., kishte një dyshek nga lëkura, mbushur me fletë palme, me gjatësi sa dy bërryla e gjerësi gati sa një bërryl e pak.

E kishte edhe një *aba* (lloj manteli arab), që e shtronte për t'u ulur kur shkonte diku. Përndryshe, flinte në hasër, asgjë përfundi saj.

Pjesë e ahlakut të tij ishte edhe vënia e emrave kafshëve, armëve e veglave; flamuri i tij quhej *Ukab*, e shpata me të cilën shkonte në beteja i quhej *Zulfikar*. E kishte edhe një shpatë që e quante *Muhazzem*, njërën me emrin *Resub*, si dhe një shpatë tjetër më emrin *Kadhib*. Dorëza e shpatës së tij ishte e punuar me argjend. Kishte një rrip të lëkurës me tri hallka nga argjendi. Harku i tij quhej *Ketum*, kurse mbajtësen për shigjeta e kishte emërtuar *Kafur*. Devja i quhej *Kasva* ('me majën e prerë të veshit'), nga ato që quhen *adba* (me vesh të prerë). Mushka i quhej *Duldul*,³⁶ gomari *Ja'fur*,³⁷ e delja nga e cila pinte qumështin *Ajna* (syri).

E kishte edhe një enë nga balta nga e cila edhe merrte abdes edhe pinte ujë. Njerëzit i dërgonin fëmijët e tyre, e ata futeshin në shtëpinë e Resulallahut, s.a.v.s., - diçka e tillë nuk ju ndalohej - e kur gjenin ujë në këtë enë, e merrnin ta pinin dhe e derdhnin nëpër fytyrë e trup. Me këtë, ata merrnin bereqet.

³⁶ Emri i mushkës që s.a.v.s., ia dhuroi Alisë r.a.. Përdoret si shaka për kuajt e këqij, fig. automobil i vjetër, makinë lodër.

³⁷ Gazelë në ngjyrë dheu, këlysh gazele, 1/5 ose 1/6 pjesë e natës.

FALJA E RESULALLAHUT S.A.V.S., ANI PSE KISHTE FUQI
PËR HAKMARRJE

Resulallahu, s.a.v.s., ishte njeriu më i butë dhe më së shumti e donte faljen, ani pse mund të hakmirrej. Një herë, i sollën qafore nga ari dhe argjendi, e ai i ndau në mes as'habëve të tij. Një beduin u grrit, e tha:

- *O Muhammed, (a.s.), vallahi, Allahu të ka urdhëruar të jesh i drejtë! Unë nuk po e shoh që ti ishe i drejtë.*

Në këtë Resulallahu, a.s., tha:

- ***I mjeri ti, kush do të jetë i drejtë për ty pos meje?!***

Pastaj, kur personi u largua nga aty, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- ***Ma thirrni atë person përsëri, pak më pas.***

Edhe pas një sjelljeje aq të ashpër dhe të pa edukatë të personit, ia tërhoqi vëmendjen atij me fjalë të ëmbla, e thirrja më pas ishte që të mos frikësohet personi.³⁸

E Xhabiri r.a., tregon se Resulallahu, a.s., po i ndante argjendët e mbledhur në ditën e Hajberit mbi rrobën e shtrirë të Bilallit, e një person i tha:

- *O i Dërguar i Allahut, ndarjen bëje drejtë!”,*

³⁸ Hadithin e transmeton Ebush-Shejh nga Ibn Omeri, me një varg pasuesish të mirë.

në çka Resulullahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **I mjeri ti, nëse unë nuk veproj drejtë, atëherë kush mundet të veprojë drejtë? Atëherë në këtë çështje do të dëmtohesha! Prandaj si nuk jam i drejtë?**

Hazreti Omeri r.a., u ngrit, e tha:

- *T'ia këpus kokën! Ky është munafik!!*; në çka Resulullahu, a.s., tha:

- ***Neudhubillah, e pastaj njerëzit të thonë se i vras as'habët e mi!***³⁹

Ishte në një nga betejat, kur armiku e shfrytëzoi pakujdesinë e myslimanëve, dhe duke u afruar me shpatë në dorë, i tha Resulallahut s.a.v.s.:

- *Kush do të mbrojë tash nga unë?*

- **Allahu**; tha Resulullahu s.a.v.s., e atij i ra shpata nga dora. Resulullahu, a.s., ia mori shpatën, dhe tha:

- ***E ty kush do të mbrojë nga unë?***; e personi i tha:

- *Bëhu më i mirë se unë, falëm!*

Resulullahu, a.s., atëherë tha:

- ***Thuaj: Eshhedu en la ilahe illallah ve eshedu enne Muhammeden abdu-hu ve resuluh*** (Dëshmoj se nuk ka ilah përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut). Personi tha:

³⁹ Hadithin e transmeton Muslimi.

- *Këtë nuk mundem ta them. Mund vetëm të them se më nuk do të luftoj kundër teje, por nuk do të jem as me ty e as me ata që janë kundër teje.*

Me këtë Resulallahu, a.s., e lëshoi të lirë. Njeriu shkoi tek njerëzit e vet dhe u tha:

- *Po vij nga takimi me njeriun më të mirë.*⁴⁰

Enesi, r.a., transmeton se një çifute ia solli Resulallahut, a.s., një dele të helmuar që ta hajë. Kur e kapën dhe e sollën tek Resulallahu s.a.v.s., ai e pyeti pse e kishte bërë këtë, e ajo tha:

- *Desha të të vras. Atëherë Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Allahu nuk ta mundësoi një gjë të tillë.***

As'habët kërkuan që t'a ekzekutojnë, ndërsa ai u tha:

"Lëreni të shkojë."⁴¹

Një çifut i bëri *sahir* (magji) Resulallahut a.s., për çka e lajmëroi Xhebarili, a.s., prandaj Resulallahu a.s., e nxori magjinë, e zgjidhi dhe ndjeu lehtësim. Asnjëherë nuk i'a përmendi këtë çifutit.⁴²

⁴⁰ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

⁴¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

⁴² Hadithin për këtë e transmeton Nesai nga Zejdi ibn Erkam, në kuptim të njëjtë gjendet tek Buhari dhe Muslimi nga Aishe r.a.

Hazreti Alia r.a., rrëfen:

“Resulallahu (a.s) na dërgoi për rrugë mua, Zubejirin dhe Mikdadin, e na tha:

- Ecni deri sa të mbërrini në bahçen ‘Hab’. Aty është një grua e martuar. Tek ajo është një shënim. Merreni shënimin.

Ne u nisëm, e kur arritëm, e gjetëm këtë gruan, e i thamë të na japë shënimin. Ajo thoshte se nuk ka asnjë shënim, e ne i thamë:

- Do ta nxjerrësh shënimin, apo t’i zhveshëm rrobat!

E nxori shënimin nga gërsheta e flokëve, dhe ne ia sollëm Resulullahut s.a.v.s.. Në atë shënim, Hatib ibn Ebi Belta u shkruante disa mushrikëve në Mekë dhe i lajmëronte për disa punë të Resulullahut s.a.v.s.. Resulallahu s.a.v.s., e pyeti:

- Çka është kjo Hatib?!, e ai tha:

- O Resulallah! I mbaja lidhjet me popullin tim. Disa nga muhaxhirët tuaj kanë të afërm në Mekë, që ju mbrojnë familjet. Unë nuk kam të afërm, prandaj dëshirova të ma bëjnë një nder e të ma ruajnë edhe mua familjen. Nuk e bëra nga mosbesimi, e as për t’u larguar nga besimi, tash që e kam pranuar Islamin.

Në këtë, Omeri r.a., tha:

- O Resulallah, më lejo t'ia këpus kokën këtëj mynafiku!; por Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Ai ka qenë në Bedër. E Allahu Teala për luftëtarët e Bedrit thotë:**

'Bëni çfarë të doni, unë veçse ju kam falur!'⁴³

Resulallahu, s.a.v.s., po bënte shpërndarjen e *ganimetit*, kur njëri nga ensarët tha:

- *Kjo shpërndarje nuk përputhet me rizanë e Allahut.*

Kur e lajmruan për këtë, Resulallahut s.a.v.s., iu skuq fytyra, dhe tha:

- **Allahu e mëshiroftë vëllaun tim Musanë! E kanë shqetësuar edhe më shumë, por u tregua i durueshëm.**⁴⁴

Më pas, Resulallahu s.a.v.s., tha:

"Mos të më sjellë asnjëri prej jush fjalë kundër as'habëve të mi! Në mesin tuaj dua të jem me kënaqësi."⁴⁵

⁴³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi

⁴⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Mesudi r.a.

⁴⁵ Ebu Davud dhe Tirmidhiu nga Ibn Mesudi r.a.

SI E MBYLLTE RESULALLAHU S.A.V.S., SYRIN NGA AJO
QË NUK E PËLQENTE

Resulallahu, s.a.v.s., kishte lëkurë të butë, i bukur e i këndshëm, nga brenda e nga jashtë. Në fytyrë i lexohej hidhërimi dhe gëzimi. Kur mërzitej, më shumë do ta lëmonte mjekrrën e tij të bekuar. Kur nuk i pëlqente diçka, nuk e përkrahte.

Njëherë i erdhi një njeri me fustan të verdhë dhe kjo nuk i pëlqeu, por nuk tha gjë. Pasi që personi u largua, ju tha disave:

- Sikur ta kishit këshilluar që të mos veshte këtë fustan të verdhë.

Një beduin filloi të urinonte në qoshe të xhamisë. As'habët iu vërsulën, e Resulallahu, s.a.v.s., ju tha:

- ***Mos e ndërpreni*** (të kryej urinimin),

e më pas tha:

- Xhamisë nuk i ka hije papastërtia, as urina, as jashtëqitja;

e në një transmetim tjetër:

- ***Afroni*** (njerëzit), ***e mos i bëni të ndjejnë urrejtje.***⁴⁶

⁴⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi r.a.

Një beduin i kërkoi diçka, e kur ia dha, Resulullahu, a.s., e pyeti:

- A je i kënaqur?;

në çka beduini tha:

- Jo, nuk jam. Nuk bëre gjë të mirë.

Ata që ishin prezent u mlllefosën dhe i'u vërsulën, por Resulallahu a.s., u dha shenjë të mos e prekin. Pastaj u largua dhe hyri në shtëpinë e vet. Pas një kohe e ftoi beduinin, i dha edhe diçka, dhe prapë e pyeti:

- Tani, a je i kënaqur?;

e beduini u përgjigj:

- Po, tani jam, Allahu të shpërbleftë, familjen e të afërmit! Resulallahu s.a.v.s, tha:

- Më parë i the ato fjalë e as'habëve ju erdhi rëndë kur i dëgjuan, prandaj, nëse do, shko thuaj para tyre këto fjalë që m'i the tash e të nxjerrësh nga gjoksi i tyre gjithë atë mlllef që kanë ndaj teje.

Beduini tha se do ta bëjë, dhe të nesërmen në mëngjes erdhi prapë në mexhlis, e Resulullahu, a.s., tha:

- Ky beduin e tha atë që e tha, dhe ne i dhamë më shumë. Mendoj se tani është i kënaqur. A është ashtu?

Beduini u përgjigj:

- Po, Allahu të shpërbleftë, familjen dhe të afërmit!"

Resulallahu s.a.v.s. pastaj tha:

- *Kjo është si shembulli i atij që i ka ikur deveja. Njerëzit e ndjekin për ta kapur e ajo edhe me shumë largohet. Më pas pronari thotë: ‘Mos e ndjekni! Na lini vetëm. Unë me të kam qenë më i mëshirshëm dhe e njoh më së miri.’* E merr një tufë bar në dorë dhe fillon ta thërrasë devenë e deveja afrohet ngadalë dhe përkulet pranë tij, e më pas ai e përgadit dhe i hip. Sikur t’ju lija ta dënoni këtë njeri për atë që e tha e ju ta vrisnit, ai do të shkonte në Xhehenem.⁴⁷

XHYMERTLLËKU (BUJARIA) E RESULALLAHUT S.A.V.S..

Resulallahu, s.a.v.s., ishte njeriu më mirëbërës dhe më bujar. Gjatë Ramazanit ishte si era që fryn e nuk lë asgjë pranë vetes. Alia r.a., kur e përshkruante, thoshte:

“Ishte njeriu më bujar, më shpirtmiri, më krahëhapuri, më i sinqerti e më i besueshmi, me natyrë të butë e miqësi fisnike. Ai që e shihte rastësisht, ndjente frikë-respekt ndaj tij, e kush e njihte më gjatë - e donte.”

Ai që e përshkruante, do të thoshte:

“Kurrë, as para tij e as pas tij, nuk kam parë dikë si ai.”

⁴⁷ Bezzar dhe Ebu’sh Sheh nga Ebu Hurejre r.a.

Çdo gjë që i kërkohej, nëse e ka, e jepte; nëse mund ta gjente, e jepte fjalën, e nëse jo, heshtte. Njëherë i erdhi dikush dhe kërkoi nga ai, e Resulallahu, a.s., i dha një tufë dele sa u mbush qafa mes dy kodrinave. Ky u kthye te populli i vet e ju tha:

“Pranoni islamini! Muhammedi a.s., jep shumë e nuk frikësohet nga varfëria.”

Nëse diçka i është kërkuar, kurrë nuk ka thënë ‘jo’.

Njëherë i sollën 90 mijë dërrhemë, e ai i vendosi mbi hasër dhe filloi t’i shpërndante secilit që erdhi, deri sa i përfundoi të gjitha, e pastaj shkoi.⁴⁸

Ta dëgjojmë një ngjarje që e rrëfen Hz. Omeri r.a.:

- Erdhi një fukara tek Resulallahu s.a.v.s., e ky nuk e kishte atë që ia kërkoi. U mërzi shumë, e më pas i tha fukarasë të shkojë në çarshi të blente çka i duhet, ta shënojë emrin e tij (a.s.) si borxhli e t’i thotë shitësit se Resulallahu do t’ia kthejë borxhin në mundësinë e parë. Resulallahu s.a.v.s., e kishte ndihmuar edhe më parë të njëjtin person, dhe duke e ditur këtë, Omeri r.a., tha:

- O Resulallah, këtij i keni ndihmuar edhe më parë, a pati nevojë t’ia plotësosh edhe këtë kërkesë?

⁴⁸ Dëshminë e kësaj e gjejmë tek Buhariu, hadithi i të cilit transmetohet nga Enesi, r.a.

Pejgamberi s.a.v.s., nuk ishte i kënaqur nga këto fjalë të Omerit r.a., që u kuptua nga shprehja e fytyrës së tij. Atëherë, njëri nga ensarët tha:

- *O Resulallah, dhuro; Allahu Teala, që është mbizotërues i Arshit, nuk ju le juve të bini në varfëri.*

Resulallahut s.a.v.s., i pëlqeu mendimi i tij, dhe tha:

- ***Unë jam urdhëruar të mos frikësohem nga dhënia e varfëria.***⁴⁹

Kur u kthye nga Hunejna, i erdhën beduinët duke kërkuar lëmoshë, derisa e mbështetën për një pemë. I'a shqyen edhe xhyben.

Resulallahu, a.s., ndaloi dhe u tha:

- ***Ma ktheni xhyben! Po të kisha dele, edhe aq sa ka drunjë Ummugajlan, të gjitha me ju do t'i ndaja. Në këtë premtim nuk do të më shihni koprrac, as gënjeshtar, as frikacak.***⁵⁰

⁴⁹ Tirmidhiu në '*Shemail*' nga Omeri, r.a.

⁵⁰ Buhariu nga Xhubejri.

TRIMËRIA E RESULALLAHUT S.A.V.S..

Resulallahu s.a.v.s., ishte njeriu më i guximshëm dhe më trim.

Alia r.a., ka thënë:

“Ke mundur të na shohësh në ditën e Bedrit se si fituam përkrah Resulallahut, s.a.v.s., kur ai ishte më së afërmi armikut dhe më i ashpri ndaj tyre.”⁵¹

Gjithashtu ka thënë:

“Kur beteja ashpërsohej e zgjerohej, dhe palët ndesheshin, ne kërkonim strehimin tek Resulallahu s.a.v.s., derisa nuk ishte askush më afër armikut se ai.”⁵²

Është thënë se Resulallahu, s.a.v.s., fliste pak. Por, kur vinte koha e betejës, ai shpejtonte, niste urdhrat e luftës dhe vepronte me tërë fuqinë.⁵³

Ishte më guximtari. Trim ishte ai që i afrohej Resulallahut a.s. gjatë luftës, sepse ai qëndronte më së afërmi armikut.⁵⁴

⁵¹ Ebu’sh-Shejh në **‘Ahlakun-nebijjun’**.

⁵² En-Nesai me një varg pasuesish të besueshëm. Hadith të tillë transmeton edhe Muslimi nga el-Berra.

⁵³ Ebu’sh-Shejh nga Sada ibn Ijaz.

⁵⁴ Muslim nga el-Berra.

Imran ibn Husein rrëfen:

“Kur Resulallahu, a.s.v.s., ndeshej me armikun, godiste i pari. Kishte fuqi të madhe.”

Kur iu afruan myshrikët, në betejën e Hunejn, ai zbriti nga mushka e tij, dhe tha:

“Unë jam Pejgamber, nuk ka gënjeshtër në këtë që them! Unë jam djali i djalit të Abdylmyttalibit.”⁵⁵

Atë ditë, askush nuk u pa të jetë më trim as më i fuqishëm sesa ai.

⁵⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi.

MODESTIA E RESULALLAHUT S.A.V.S..

Edhe pse e kishte pozitën më të lartë, Resulallahu s.a.v.s., ishte njeriu më modest.

Ibn Amiri na tregon:

“E kam parë në kohën e haxhit, mes njerëzve, se si nga deveja ngjyrë hiri gjuante guralecë (Xhemretul-Akabe) si të tjerët, nuk shtyente njeri.”

Kur hipte në gomar, i'a vendoste kadifenë, e në samar merrte edhe dikë tjetër. I vizitonte të sëmurët, i përcjellte xhenazet dhe i përgjigjej thirrjes së skllavit. I rregullonte mbathjet, arronte rrobat dhe së bashku me familjarët i bënte edhe punët e shtëpisë.

As'habët nuk ngriteshin para tij, sepse e dinin që ai nuk e pëlqente një gjë të tillë. Kalonte pranë fëmijëve dhe ju jepte selam. Një ditë, Resulallahu s.a.v.s., shkoi te një person, e ai nga *hejbet*-i⁵⁶ i tij u frikësua, e filloi të dridhej. Resulallahu s.a.v.s., i tha:

“Ngadalë, unë nuk jam mbret. Unë jam djali i një gruaje nga fisi Kurejsh e cila hante mish të terun.”⁵⁷

⁵⁶ **Hejbet:** madhështia; gjendja që jep ndjenjën e frikë-respektit; madhëria.

⁵⁷ Hakim nga Xheriri.

Ulej në mesin e as'habëve si të ishte njëri nga ta. Kur vinte ndonjë i huaj, po të mos pyeste, nuk e dinte se cili ishte Resulullahu s.a.v.s.. As'habët e kuptuan që nuk bën kështu dhe ia ndërtuan një ulëse më të lartë, prej balte, e ulej në të.

Një herë, Aisha r.a., i tha:

- *Mbështetu e ha! Do ta kesh më lehtë.*

Ai e uli kokën, aq sa e preku tokën me të, dhe tha:

- ***Jo. Unë ha si rob, dhe ulem si rob.***⁵⁸

Nuk hëngri nga pjata, as në sofër, as në tavolinë. Nuk hante bukë të hollë e të pjekur mirë.⁵⁹

Kushdo që e thërriste, i përgjigjej me '*lebbejk'*' (urdhëro). Kur ulej me njerëz e ata fillonin të flasin për ahiretin, edhe ai merrte pjesë, nëse bisedonin për ushqimin apo pijen, prapë merrte pjesë në bisedë, e edhe kur bisedonin për gjërat e dynjasë merrte pjesë, gjithnjë prej ndjeshmërisë dhe modestisë që kishte ndaj tyre.

Ndonjëherë para tij recitonin poezi e flisnin për ngjarjet nga koha e *xhahiletit* (periudhës para-islame), dhe qesheshin së bashku. Kur ata qesheshin, edhe ai qeshte. Nuk i ndalonte nga asgjë tjetër, pos nga harami.

⁵⁸ Ebu'sh-Shjeh nga Abdullah ibn Ubejde.

⁵⁹ Buhariu nga Enesi r.a.

PAMJA DHE QËNDRIMI I RESULALLAHUT S.A.V.S.

Duke e përshkruar Resulallahun, s.a.v.s., transmetohet se nuk ka qenë shumë i gjatë, as i shkurtër. E megjithatë, kur ecte mes njerëzve, ai ishte më i gjatë. Resulallahu s.a.v.s., dukej më i gjatë nga të gjithë. Kur ecte i vetëm, dukej mesatar, e prapë nuk ka ndodhur të ecë bashkë me dikë, e ai të duket më i gjatë se Resulallahu s.a.v.s.. Ka ndodhur që ta rrethojnë dy njerëz të gjatë, e prapë të duken vetëm gjer te shpatullat e Resulallahut a.s. Kur largoheshin nga ai do të thuhej se janë persona të gjatë, e për Resulallahun s.a.v.s., do të thuhej se ishte me gjatësi mesatare. Thoshte:

“Çdo e mirë është në mes.”

Sa i përket ngjyrës së tij (të lëkurës e të fytyrës), ishte ngjyrë e shndritshme; nuk ishte ngjyrë e errët, por as e veçuar në të bardhë. Shndritjen e lëkurës e kishte bardhësi të pastër, në të cilën nuk kishte as verdhësi, as të kuqërremtë, e as ngjyrë tjetër. Axha i tij, Ebu Talib, e ka përshkruar në vargje:

“Fytyrë e bardhë që, për nder të asaj fytyre të bardhë kërkohet shi, është streha e jetimëve dhe kalaja e vejushave.

Disa kanë thënë që në fytyrë kishte ngjyrë të kuqërremtë, por tregohet se e kuqja ishte vetëm në ato pjesë që i kishin pasur kontakt me diellin dhe erën, pra në qafë e fytyrë. Pjesët tjera të trupit, që mbuloheshin me rroba, e kishin një bardhësi të pastër. Djersa i shndriste si margaritar dhe i kishte aromë të mirë, si misku. Kishte flokë të bukura, as të drejta e as kaçurrela. Kur i krihte, i dukeshin si valëzim i shkretëtirës. Thuhet se flokët i arrinin gjer në supe, edhe pse disa thonë deri te llapa e veshit. Ndoshta i mbështjellte flokët, kështu që të dy veshët vinin në pah në mes të kaçurrelave, e ndoshta i lëshonte mbi veshë, kështu që zylyfët i dukeshin më të shëndritshëm. Në flokë dhe mjekër kishte shtatëmbëdhjetë qime të bardha, jo më shumë. Kishte një fytyrë të bukur dhe me plot shkëlqim. Askush nuk e përshkruante, e të mos e krahasonte me hënën e plotë. Për shkak të pastërtisë së lëkurës së tij, si gëzimi si hidhërimi mund t'i lexoheshin në fytyrë. Thuhet se ishte ashtu siç e përshkruajti shoku i tij Ebu Bekr as-Siddik, r.a., kur tha:

“Mustafaja, ishte një i besueshëm që thërriste njerëzit në lumturi. Si hëna e plotë që errësirën ndriçon.”

Kishte ballë të hapur, vetulla të gjata, të holla. Vetullat i kishte të ndara, e hapësira mes tyre i shkëlqente si argjend. Kishte sy të zi, të mëdhenj e të bukur. Në sy i shihej edhe një nuancë e kuqërremtë.

Kishte qerpikë të gjatë, e dendësia e tyre thujase ia mbulonte shikimin. Hundën e kishte të drejtë. Dhëmbët i kishte të ndarë. Kur buzëqeshte, dhëmbët i shkëlqenin, si inxhi. Në mesin e robëve të Allahut kishte buzët më të bukura. Faqet i kishte të buta dhe të lëmuara. Fytyrën nuk e kishte të gjatë, por as të rrumbullakët. Kishte mjekër të dendur. Mjekerën e lëshonte, e mustaqet i shkurtonte. Kishte qafën më të bukur nga robët e Allahut, as të gjatë e as të shkurtër. Pjesa e qafës që kishte kontakt me diellin dhe erën i shkëlqente si ibrik argjendi, i gdhendur me ar.

Kishte gjoks të gjerë. Tulin nuk e kishte të varur. Ishte i drejtë si pasqyrë, sikur hëna në bardhësinë e saj. Nga mesi i gjoksit deri tek kërthiza, i shtrihej një vijë e qimeve. Qime të tjera në gjoks dhe bark nuk kishte. Kishte shpatulla të gjera dhe eshtra të fortë; pra eshtrat e krahërorit, bërrylave dhe kukave. Kishte shpinë të gjerë. Në mes të supeve i ndodhej vula e *Nubuvetit* (pejgamberllëkut), pak më lartë kah supi i djathtë. Kjo ishte një shenjë e zezë që përshkohej me një nuansë të verdhë. Rreth saj kishte qime, sikur të ishin jele e kalit. Krahët i kishte të mëdhenj. Kyçin e dorës dhe duart i kishte të gjera. Gishtat i kishte të gjatë dhe me shkëlqim, si argjend. Shuplaka e dorës i ishte më e butë se gishti dhe ishte aromatike.

Ai që ia shtrëngonte dorën (*musafaha*) deri në mbrëmje e ndjente aromën në dorë. Cilit fëmijë i vënte dorën në kokë dhe e përkëdhelte, koka e atij fëmije deri në mbrëmje veçohet nga fëmijët e tjerë me aromë të mirë.

Pulpat e këmbëve i kishte të mëdha, e kur ecte, dukej sikurse po zbriste ngadalë nga shpati. Hapat i kishte të matur. Ecte ngadalë e shkathët, dhe me hapa njëri pranë tjetrit. Thoshte:

“Unë jam nga njerëzit më i ngjashëm me Ademin Alejhisselam, derisa Ibrahim Alejhisselam është më i ngjashmi me mua, edhe nga pamja edhe nga ahlaku.”

Poashtu thoshte:

“Unë tek Rabbi im kam dhjetë emra. Unë jam *Muhammedi*. Unë jam *Ahmedi*. Unë jam *Mâhi* - Allahu Teala me mua do të shkatërrojë kufirin. Unë jam *Akib* - pas meje nuk ka Pejgamber. Unë jam *Hashir* - pas meje Allahu Teala do t'i ringjallë (mbledhë) pas vdekjes robët e Tij. Unë jam *Resul'i rahmet* (i dërguari i mëshirës). Unë jam *Resul'i tevbese* (i dërguar i pendimit). Unë jame *Resul'i Melahim*. Unë jam *Mukaffi*. Unë jam *Kusem* (i përsosur), dhe jam njeriu që i ka mbledhur të gjitha mirësitë.”⁶⁰

⁶⁰ Ebu'sh-Shejh nga Abdullah b. Ubejdi.

MUXHIZET DHE SHENJAT QË E DËSHMOJNË VËRTETËSINË E RESULALLAHUT S.A.V.S.

Dije se: ai që e kupton Muhammedin s.a.v.s., punët në lidhje me ahlakun e tij, gjendjet dhe sjelljet e tij, adetin dhe karakterin, ballafaqimin dhe miqësimin me njerëz të ndryshëm, udhëzimin dhe rregullimin e punëve të tyre, udhëheqjen e tyre drejtë nënshtrimit, të gjitha ato çfarë thuhet në përgjigjet e tij të mahnitshme për pyetje të ndërlikuara, vlerësimin e tij për të mirën dhe mirëqenien e njerëzve, diturinë e tij, kujdesin e tij, maturinë e tij, si ishte parandalues; që secili dijetar, fakih e i mençur që kupton shenja të bukura në shpjegimet e urdhrave të Sheriatit, është mahnitur përgjatë gjithë jetës; dhe nëse mendon mirë – ai nuk do të ketë kurrë dyshime se këto asesi nuk përfitohen me fuqinë e vullnetit të njeriut, me mashtrimet me të cilat njerëzit zakonisht merren, dhe nuk do të ketë kurrë dyshime se këto përfitohen vetëm me ndihmën e fuqisë hyjnore dhe qiellore. Gjithë këtë është e pamundur ta imagjinosh nga një gënjeshtar dhe mashtrues.

Aftësitë e tij dhe gjendja janë dëshmi shumë të forta mbi vërtetësinë e tij. Kur do ta shihte, edhe arabi nga shkretëtira, do të thoshte:

“Vallahi, kjo fytyrë nuk mund të jetë gënjeshtër.”

Vërtetësinë e tij e dëshmonte vetëm me paraqitje të jashtme, e çfarë të thuhet për ata që e dëshmuuan edhe ahlakun e tij dhe i përjetuan gjendjet e tij, në çfarëdo situatë!

Ne përmendëm një pjesë nga ahlaku i tij, që të njihen virtytet e tija të mira, të tregohet vërtetësia e tij, grada dhe pozita e tij e lartë tek Allahu Teala. Allahu ia dha të gjitha këto, e ishte pa shkollë, nuk i studioi dituritë, nuk lexoi libra e nuk udhëtoi në kërkim të diturisë. Ka jetuar në mes të bjeshkëve dhe në mesin e beduinëve, si jetim. Në qoftë se nuk do t'a arrinte ndihma e Allahut Teala ku do të mësonte ai këto vlera të larta, bukuritë e ahlakut dhe urdhërat, e të mos i përmendim njohuritë e tjera. Ku është njohja e Allahut Teala, Librave dhe melekëve të Tij, veçoritë e Pejgamberëve dhe gjithçka tjetër sa i përket besimit.

Po të mos i arrinte Shpallja (*vahj*) nuk do t'i dinte këto gjëra, e fuqia e njeriut nuk ka mundësi ta bartë vet një barrë aq të rëndë. Edhe po të mos kishte asnjë *muxhize*, vetëm paraqitja e tij e jashtme do të ishte e mjaftueshme për të dëshmuar *nubuvvetin* (pejgamberllëkun) e tij. E megjithëkëtë, Resulallahu s.a.v.s., ka muxhize aq që kurrsesi nuk lëjnë vend për dyshim.

Të tregojmë tani disa nga muxhizet e tij të njohura, që gjenden në libra të besueshëm, duke mos hyrë në detaje;

Allahu Teala përmes tij e ka prishur rregullin e zakonshëm të gjërave disa herë; kur Kurejshët i kërkuan një shenjë, Hëna u nda në dysh.⁶¹

Gjatë ngjarjes së Hendekut në shtëpinë e Xhabirit dhe Ebu Talhes ka ushqyer me pak gjellë shumë njerëz⁶² e njëherë ushqeui tetëdhjetë persona me vetëm katër duar plot elb dhe një edh, pak më të vjetër se një vjet.⁶³ Një herë ushqeui më shumë se tetëdhjetë persona me një copë bukë elbi që Enesi e mbante në dorë⁶⁴, e një herë tjetër e ushqeui ushtrinë me pak hurme të cilat i solli e bija e Bishrit.⁶⁵

Në luftë të Tebukut, kur ushtria kërkoi ujë nga Resulallahu s.a.v.s., ky pyeti:

- A nuk ka hiç ujë?

Kishte pak ujë në një *matara*, atë ia sollën, e mori në dorë, dhe në mes të gishtave të tij të bereqetshëm filloi të rridhte uji nga i cili piu e tërë ushtria e etur, morën abdes dhe mbushën enët e ujit.⁶⁶

⁶¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Mesudi, Ibn Abbasi dhe Enesi, r.a.

⁶² Buhariu dhe Muslimi nga Enesi, r.a.

⁶³ Bejhaki nga Xhabiri r.a., edhe Buhariu, por nuk përmend numrin e personave të cilët atëherë ishin duke ngrënë.

⁶⁴ Muslimi nga Enesi r.a.

⁶⁵ Bejhaki në '*Dalailu'n--Nubuvvet'*.

⁶⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi, r.a., por vetëm me përmendjen e abdesit. Uji i cili qarkullon përmes gishtave përmendet në hadithin që e shënon Ebu Nuajm me një varg transmetuesish të mirë. Poashtu, Taberani në '*Kebirin'* e tij shënon hadithin nga Ibn Abbasi, r.a., në të cilin thuhet se si njëherë, derisa ishin në udhëtim,

Poashtu, Resulallahu s.a.v.s., duke derdhur pak ujë me dorë në burimet e Hudejbijje-s dhe Tebukut të cilat ishin tharë, burimet u mbushën me ujë dhe nga këto burime pinte ujë ushtria, që numëronte mijëra luftëtarë.⁶⁷

Një herë, Resulallahu, s.a.v.s., i urdhëroi Omerit r.a., që të furnizojë katërqind kalorës me hurme e që kishte vetëm sa një hapësirë që e zë deveja kur gjunjëzohet, e megjithatë i furnizoi aq shumë sa edhe tepruan.⁶⁸

Ushtrisë armike u hodhi pluhur syve, dhe ata nuk mund të shihnin.⁶⁹ Në lidhje me këtë zbriti edhe ajeti:

“Dhe nuk hodhe ti, kur hodhe, por hodhi Allahu.”

8-Enfal: 17

Me dërgimin e Muhammedit a.s., Allahu Teala e anuloi *kehanet*-in.⁷⁰ Më parë kishte kehanet.

as’habët ankoheshin tek i Dërguari, s.a.v.s., për etje, në çka ai tha: *“Më sillni ujë!”* Ata i sollën një enë me ujë, ai e vendosi dorën e tij në të, kur uji filloi të rrjedhte mes gishtave të tij.

⁶⁷ Buhariu dhe Muslimi. Hadithi për burimin në Tebuku e shënon Muslimi nga Muadhi r.a., derisa hadithi për atë në Hudebije lidhet për Seleme ibnul-Ekvea. Këtë mrekulli të Të Dërguarit a.s. e dëshmon edhe hadithi te Buhariu nga Ber.

⁶⁸ Hadithin për këtë e shënon Ahmed ibn Hanbel nga en-Nu’mana ibn Mukarrin dhe Dukejn ibn Seid me një varg pasuesish të besueshëm

⁶⁹ Këtë e vërteton hadithi i cili transmetohet nga Ibn Merdevejh në *Tefsirin* e tij nga Xhabiri dhe Ibn Abbasi, r.a.

Kur Resulallahu s.a.v.s. u ngjit në mimerin e sapo-ndërtuar, trunq i hurmes në të cilën mbështetej Resulallahu s.a.v.s., kur mbante hutben para se të ndërtohej mimeri, filloi të qajë, duke mos e duruar ndarjen. Vajin e tij si zëri i devesë e dëgjuan të gjithë as'habët. Resulallahu s.a.v.s., zbriti nga mimeri dhe e përqafoi trunqun, e trunqun heshti.⁷¹

Ju bëri thirrje çifutëve që ta dëshirojnë vdekjen, duke i informuar se këtë gjë me siguri nuk do ta dëshirojnë, dhe në të vërtetë kështu ndodhi, dhe kështu dëshmoi heshtjen e tyre. Ajeti i cili e shpjegon këtë ngjarje është duke u lexuar në tërë botën.⁷²

Resulallahu, a.s., jepte lajme edhe për gjërat e fshehta. Kështu, e lajmëroi Osmanin r.a., se do t'i ndodhë një fatkeqësi dhe do të hyjë në Xhennet,⁷³ e Amarin (ibn Jasir) se si do ta vrasin një grup i rebelëve.⁷⁴ Thoshte se me Hasanin (nipin e tij) r.a., Allahu do të pajtojë dy ushtri islame.⁷⁵ Për një person thoshte se do të hyj në xhehnem, ani pse ai ka luftuar në rrugën e

⁷⁰ *Kehanet*: fjalë orakulli; profeci; parashikim fati.

⁷¹ Buhariu nga Xhabiri dhe Sehl ibn Sa'd, r.a.

⁷² Buhari nga Ibn Abbas, r.a.

⁷³ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa el-Esh'ari.

⁷⁴ Muslimi nga Ebu Katade dhe Ummu Seleme. Buhariu nga Ebu Seid.

⁷⁵ Buhariu nga Ebu Bekri.

Allahut. Më vonë u zbulua se ai person bëri vetëvrasje.⁷⁶

Këto janë lajme nga shpallja hyjnore, të cilat nuk mund të njihen nga përvoja, nga vrojtimi i yjeve, vijat në rërë apo kah po fluturojnë zogjtë, por vetëm me lajmërim nga Allahu Teala dhe me Shpalljen e Tij.

Kur Resulallahu s.a.v.s., e lëshoi Mekën dhe u nis për në Medine, Suraka ibn Malik po i shkonte pas, e këmbët e kalit të tij u mbërthyen në zall e pluhuri u përhap. Suraka thirri për ndihmë, e Resulallahu s.a.v.s., bëri dua, e kali u lirua. Resulallahu s.a.v.s., e paralajmëroi Surakan që do të vë në duar prangat e Kisras, perandorit të Persisë. Ashtu edhe ndodhi.⁷⁷

Lajmëroi për vrasjen e gënjeshtarit Esvad-i Ansi, në natën kur ai u vra, edhe pse ai ishte në Sana, qytet në Jemen. Madje edhe e emëroi edhe vrasësin.⁷⁸

Doli para qindra Kurejshëve që po e prisnin për ta vrarë, hodhi para tyre një grusht dhé, dhe ata nuk e panë.⁷⁹

⁷⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre dhe Sehl ibn Sa'd.

⁷⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Bekr es-Siddik r.a.

⁷⁸ Hadithet për këtë i shënojnë edhe Buhariu, dhe Muslimi nga Ebu Hurejre, r.a.

⁷⁹ Ibn Merduje nga Ibn Abbasi, r.a.

Një herë, në prani të as'habëve të vet, iu afrua një deve dhe filloi t'i ankohet Resulallahut s.a.v.s., për pronarin.⁸⁰

Një herë tjetër, në prani të as'habëve të vet, tha se njëri prej tyre do të përfundojë në Xhehenem, dhe se dhëmballën do ta ketë sa kodra e Uhudit. Të gjithë vdiqën si myslimanë të mirë, pos njërit, i cili më vonë e braktisi fenë islame dhe u vra në atë gjendje (*myrted*). Një grupi tjetër njerëzish, ju tha:

“Ai që vdes i fundit prej jush, do ta humb jetën në zjarr.” Ashtu edhe ndodhi. I fundit nga ta ra në zjarr, aty u dogj, dhe ashtu vdiq.⁸¹

I thirri dy drunjë, ata u përgjigjën dhe iu afruan, e pastaj i urdhëroi të kthehen, dhe dy drunjtë u kthyen në vend.⁸²

Resulallahu, a.s., ishte me gjatësi mesatare, por kur ecte bashkë me njerëz më të gjatë, dukej më i gjatë se ata. Edhe kjo ishte nga muxhizet e tij.

I ftoi të krishterët në mallkim dhe i njoftoi se nëse e pranojnë këtë ftesë, do të shkatërrohen. Ata besuan se po e thotë të vërtetën, dhe u tërhoqën.⁸³

⁸⁰ Ebu Davud nga Abdullah ibn Xhafer r.a.

⁸¹ Taberani dhe Bejhekiu.

⁸² Ahmed ibn Hanbel nga Ali ibn Murre me pasues të besueshëm.

⁸³ Buhariu nga Ibn Abbasi, r.a.

Amir ibn Tufejl me Erded ibn Kajs, kalorës të shquar arabë, erdhën ta vrasin Resulallahun s.a.v.s., por para tyre u shfaq një pengesë, e Resulallahu s.a.v.s., shpëtoi dhe i mallkoi. Amiri vdiq nga sëmundja e gjëndrrave, ndërsa Erbedin e dogji vetëtima.⁸⁴

Për Ubej ibn Halef, Resulullahu s.a.v.s., njoftoi se ai do ta vriste, dhe kështu në ditën e Uhudit vetëm pak e gërvishi dhe Ubej ibn Halef vdiq.⁸⁵

Bashkë me shokun e tij hëngrën mish të helmuar; shoku i vdiq menjëherë, por Resulallahu s.a.v.s, pas asaj ngjarje ka jetuar edhe katër vite. Për më shumë, pjesa e helmuar e mishit (shpatulla) foli dhe i tregoi Resulallahut s.a.v.s., që është e helmuar.⁸⁶

Në ditën e Bedrit, Resulallahu a.s. i njoftoi njerëzit për vendin ku do të vdesin prijësit e kurejshëve, dhe të gjithë e humbën jetën mu në vendin që e tregoi Resulallahu s.a.v.s.⁸⁷ Resulallahu s.a.v.s., i lajmëroi se disa nga ummeti i tij do të luftojnë në det. Kështu edhe ndodhi.

⁸⁴ Taberani në *'Evsat'* nga Ibn Abassi, r.a.

⁸⁵ Bejhakui në *'Dalailu'n- Nubuvve'* nga Seid ibn Musejjebi.

⁸⁶ Muslimi nga Omer b.Hattabi r.a.

⁸⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ummu Haram.

Sipërfaqja e Tokës u “*palos*“ dhe ia tregoi lindjen dhe perëndimin e saj. Resulallahu s.a.v.s., lajmëroi se pushteti i ummetit të tij do të zgjerohej deri te cepat e Tokës që iu kishin “*palosur*.”⁸⁸ Ashtu edhe ndodhi; pushteti i myslimanëve u zgjerua nga lindja - toka e Turqëve, deri në perëndim - te deti andaluzian dhe toka e Berberëve. Por, nuk u zgjerua drejt jugut dhe veriut, sepse ashtu nuk kishte lajmëruar Resulullahu, s.a.v.s..

Vajzën e tij Fatimen r.a., e lajmëroi se nga familja e tij (*ehl-i bejt*) ajo e para do t’i bashkangjitet në atë botë. Ashtu edhe ndodhi.⁸⁹ Gratë e tij i njoftoi se nga ato, e para do t’i bashkangjitet në ahiret do të jetë më e xhymerta prej tyre. Ajo ishte Zejnep bint Xhahsh r.a., dhe ajo e para edhe iu bashkangjit në atë botë.⁹⁰

E preku me dorë gjirin e një deleje që nuk jepte qumësht, dhe qumështi u shfaq. Kjo u bë sepse që Ibn Mesud r.a., të pranoi islamin.⁹¹ Të njëjtën e bëri edhe në tendë të Ummu Ma’bed.

Njërit prej as’habëve të tij i ra syri, e Resulullahu, s.a.v.s., me dorën e vet ia ktheu në vend, e më pas ky as’hab kishte sytë më të shëndoshë e më të bukur.⁹²

⁸⁸ Muslimi nga Aishe dhe Fatime, r.a.

⁸⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ajshe dhe Fatime r.a.

⁹⁰ Hadithin për këtë e transmeton Muslimi, nga Ajshe r.a.

⁹¹ Ahmed ibn Hanbel nga Ibn Mesudi r.a.

⁹² Hadithin për këtë e transmetojnë Ebu Nuajm dhe Bejhakui nga Katade ibn Nu’mani i cili ishte ai që i ra syri. Tek Bejhakui thuhet se

Në ditën e Hajberit, Resulallahu s.a.v.s., pështyu në syrin e hazreti Alisë r.a., që e kishte të sëmurë, dhe në atë moment syri iu shërua e Resulallahu, a.s., e dërgoi Alinë r.a., me flamur në kështjellën e Hajberit.⁹³

As'habët kanë dëgjuar lavdërimin që e bënte ushqimi që gjendej para Resulallaht, s.a.v.s..⁹⁴

Njëri nga as'habët e lëndoi këmbën, e Resulallahu a.s., vetëm sa ia preku me dorë, dhe në atë moment këmba iu shërua.⁹⁵

Në njërën nga betejat, ushqimet në ushtri filluan të mbarojnë. Resulallahu, s.a.v.s., urdhëroi që të mblidhet gjithçka që kishte mbetur, e kishte mbetur shumë pak, Resulallahu s.a.v.s., bëri dua për bereqet, e pastaj i urdhëroi të afrohen e të hanë. Njerëzit merrnin ushqim, dhe nuk mbeti asnjë enë në mesin e ushtarëve që nuk u mbush, nga ajo sasi e vogël.⁹⁶

kjo ndodhi gjatë Betejës së Bedrit, derisa Ebu Nuajm thotë se kjo ndodhi në Betejën e Uhudit.

⁹³ Buhariu dhe Muslimi nga hazreti Alia r.a., dhe Sehla bn Sa'd r.a.

⁹⁴ Buhariu nga Ibn Mesud r.a.

⁹⁵ Buhariu.

⁹⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Seleme ibnul-Ekvea.

Hikemi, djali i As b. Vail, deshi të tallet me ecjen e Resulallahut, s.a.v.s., dhe nisi të ecë duke u tundur, e Resulallahu tha:

“Ashtu bëhu”;

dhe ky tërë jetën ashtu edhe eci.⁹⁷

Resulallahu, a.s., deshi ta merrte për grua një vajzë, e babai i saj, për të mos e dhënë tha se vajza e tij e ka lebrën, e që nuk e kishte. Resulullahu s.a.v.s., i’a ktheu:

“Ashtu le të jetë!”;

dhe ajo me të vërtetë u bë me lebrë.⁹⁸ Bëhet fjalë për Ummu Shebib ibnul-Bersa.

Muxhize të Resulallahut s.a.v.s., ka edhe më shumë. Jemi kufizuar në ato të mirënjohurat. Por, për Kur’anin nuk ka asnjë dyshim, e Kur’ani është mrekulli, e tillë që vazhdon edhe sot. Asnjë peygamber nuk ka pasur mrekulli të vazhdueshme, përveç Resulallahut s.a.v.s.. Me këtë mrekulli i sfidoi gjuhëtarët dhe arabëfolësit, e në atë kohë gadishulli Arab ishte përplot me ta, me mijëra sosh. Të folurit ishte zanat i tyre. Bënin gara mes vete dhe i përsosnin aftësitë. Resulallahu s.a.v.s., i thirri të sjellin shkrime të ngjashme si Kur’ani, ose sa dhjetë

⁹⁷ Bejhaki në *‘Delailu’* nga Hinda ibn Hatixhe, edhe nga Hakimi në *‘Mustedrek’* nga Abdurrahman ibn Ebu Bekri.

⁹⁸ Hadithi për këtë transmetohet nga Ibnul-Xhevi në *‘Telkih’*, duke thënë se ajo grua quhej Xhemra bintul-Hars ibn Avf el-Muzni.

sure të tij, a të paktën një sure, nëse kanë dyshime. Allahu Teala thotë:

“Thuaj: ‘Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur’an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njëri – tjetrin’.” 17-Isra: 88

Këtë jua tha që ta bëjë të qartë pafuqinë e tyre dhe për t’i heshtur. Ata e humbën shpresën, e kuptuan pafuqinë e vet, e vendosën ta kundërshtojnë Kur’anin duke kapur shpatën. E gjuajtën veten në shkatërrim, e humbën pasurinë, dhe gratë e fëmijët e vet i dërguan në robëri. Nuk mundën ta kundërshtojnë Kur’anin; nuk mundën ta zbehin bukurinë dhe madhështinë e tij. Kur’ani u zgjerua në gjithë botën, në lindje e perëndim, nga gjenerata në gjeneratë, nga shekulli në shekull. Deri tash (koha e Gazalit), kanë kaluar gati pesëqind vjet, dhe askush nuk ishte në gjendje që ta sjellë një Kur’an të ngjashëm, as kurrë nuk do të jenë në gjendje ta sjellin.

Sa budallallëk është dyshimi në vërtetësinë e Resulallahut s.a.v.s., duke ditur për gjendjen dhe sjelljet e tij, për fjalimin, veprimin, ahlakun dhe muxhizet e tij, për vazhdimësinë e shariatit të tij deri në ditët e sotme, zgjerimin në gjithë sipërfaqen e tokës, si i nënshtrohen Islamit mbretërit e kohës së tij, e edhe pas tij, ani pse

Muhamedi a.s. ka qenë jetim; e prapë të shfaqet
dyshim mbi vërtetësinë e tij!

E sa sukses i madh për atë që beson fuqishëm në
vërtetësinë e tij dhe që e pason në gjithçka që
ndërlidhet me të!

E lusim Allahun e Madhëruar që të na dhurojë
suksese në pasimin e Muhamedit, a.s., në ahlak, vepra,
gjendje dhe fjalë.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
EDUKIMI ME KUR'AN NGA ALLAHU I TË ZGJEDHURIT DHE MË TË DASHURIT TË TIJ, MUHAMMEDIT S.A.V.S....	7
PJESË NGA AHLAKU I RESULALLAHUT, S.A.V.S., PËRMBLEDHUR NGA TREGIMET E DISA DIJETARËVE....	15
FJALIMI I TIJ DHE BUZËQESHJA E TIJ	23
EDEBI DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S., NË USHQIM.....	27
EDEBI DHE AHLAKU I RESULALLAHUT, S.A.V.S., NË VESHJE.....	33
FALJA E RESULALLAHUT, S.A.V.S., ANI PSE KISHTE FUQI PËR HAKMARRJE	37
SI E MBYLLTE RESULALLAHU, S.A.V.S., SYRIN NGA AJO QË NUK E PËLQENTE	42
XHYMERTLLËKU (BUJARIA) E RESULALLAHUT, S.A.V.S..	44
TRIMËRIA E RESULALLAHUT, S.A.V.S.	47
MODESTIA E RESULALLAHUT, S.A.V.S.....	49
PAMJA DHE QËNDRIMI I RESULALLAHUT S.A.V.S.	51
MUXHIZET DHE SHENJAT QË E DËSHMOJNË VËRTETËSINË E RESULALLAHUT S.A.V.S.....	55

